



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**  
**Komisioneri**

Nr. 3/1 Prot.

Tiranë, më 3/8/2010

**Lënda:** Rekomandim lidhur me inspektimin administrativ të datës 04/08/2010.

**Drejtuar:** “Autoritetit Portual Durrës” (A P D sh.a)

**Adresa:** Porti i Durrësit

**DURRËS**

Më datë 04/08/2010 nga grupi i inspektimit të zyrës së Komisionerit është zhvilluar inspektimi administrativ pranë jush, me cilësinë si kontrollues që mblidhni dhe përpunoni të dhëna personale në ushtrim të qëllimit dhe aktivitetit tuaj, me objekt:

- A njihet ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, dhe ç’masa janë marrë për implementimin e tij.
- Për këto të dhëna a zbatohen kushtet dhe kriteret e parashikuara në nenet 5,6,7,8,9 të ligjit “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- Ç’masa merren për sigurinë e të dhënave personale. Ku mbahen të dhënat dhe sa është koha e mbajtjes së tyre.
- Nëse kanë rregullore të veçantë për mbrojtjen e të dhënave personale ose rregulla që janë përfshirë në Rregulloren e Brendshme.
- Si zbatohen të drejtat e subjekteve të të dhënave personale.
- Nëse ka instalime të kamerave të fshehta, si përdoren ato dhe a ka paralajmërime për përdorimin e tyre.
- Nëse e njohin detyrimin për të njoftuar të dhënat personale që përpunojnë, në ç’skallë dhe si veprohet.
- Nëse dhe në ç’masë zbatohen rregullat e konfidencialitetit për përpunimin e të dhënave personale.

Komisioneri “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” pasi shqyrtoi procesverbalin e inspektimit administrativ të mbajtur me këtë rast si dhe provat e administruara konstaton:

- 1) Kontrolluesi Autoriteti Portual Durrës nuk ka kryer detyrimin ligjor për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

- Në këtë rast nuk është zbatuar neni 21 i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, “...Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i qëllimit të përpunimit, të njoftuar më parë.
- 2) Kontrolluesi mban në arshivën e tij dosje me të dhëna personale të ish punonjësve të larguar prej vitesh.
    - Këto veprime konsiderohen shkelje të kërkesave të nenit 5 pika “1/d” i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, “ Në mbajtjen në atë formë që të lejojë identifikimin e subjekteve të dhënave për një kohë por jo **më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin** për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej”.
  - 3) Kontrolluesi në funksion të realizimit të qëllimit të tij të punës u konstatua se përdor sistem vëzhgimi me kamera dhe nuk ka të përcaktuar rregulla të veçanta për mënyrën e mbledhjes e përpunimit të këtyre të dhënave, (pozicionin, këndin e vendosjes së kamerave etj..)
    - Në këtë rast nuk janë respektuar kërkesat e nenit 5, pika 1 germa “b” të ligjit nr. 9887 dt.10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”... “(grumbullimi për qëllime specifike të përcaktuara qartë, legjitime dhe në përpunimin në përputhje me këto qëllime)
  - 4) Nga ana e Kontrolluesit nuk janë përcaktuar rregulla lidhur me kofidencialitetin për të dhënat personale.
    - Moskryerja e kësaj detyre ligjore përbën shkelje të kërkesave të nenit 28 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, “Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë kofidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj.

Mbështetur në nenet 29 dhe 30 të ligjit nr. 9887 dt. 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” Komisioneri rekomandon:

1. Të merren masat e nevojshme që brenda datës 10.09.2010 të plotësohet formulari i njoftimit pranë Zyrës së Komisionerit Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke respektuar kërkesat e nenit 21 të ligjit nr. 9887 dt. 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
2. Të rishikohen formulari Model-DA-SPMM dhe formulari i aplikimit për forcën e sigurisë portale në mënyrë që të dhënat që grumbullohen të jenë të mjaftueshme për

qëllimin për të cilin mblidhen, duke respektuar kërkesat e nenit 5, pika 1 germa “c” të ligjit nr. 9887 dt. 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

3. Të zbatohen me rigorozitet kërkesat e nenit 5, pika 1 germa “b” të ligjit nr. 9887 dt. 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe udhëzimi nr.3, datë 05.03.2010 i Komisionerit Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, mbi “Sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme”.
4. Në rregulloren e organizimit dhe funksionimit të “Autoritetit Portual Durrës” të përcaktohen rregulla të hollësishme për sigurinë e të dhënave personale që përpunohen, si dhe rregulla për ruajtjen e konfidencialitetit dhe të besueshmërisë të punonjëve që vihen në dijeni me përpunimin e të dhënave personale.

Kryerja e këtyre rekomandimeve të rëndësishme për mbrojtjen e të dhënave personale që ju ngarkon ligji të realizohet brenda një afati kohor prej tre muaj.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

**KOMISIONERI**

**FLORA ÇABEJ (POGAÇE)**

